

KOLË POPA, PERSONALITET I SHQUAR I ARSIMIT DHE I SHKENCËS SHQIPTARE

(1913 – 1993)

FRASHËRI M.¹, KRAJA O.², TROJA P.¹, SHEHU E.¹

¹Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Departamenti i Kimisë Industriale.

²Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Departamenti i Matematikës.

Në historinë 50-vjeçare të Universitetit të Tiranës, pa dyshim që ka një vend nderi akademik, Mësuesi i Popullit, përgjegjësi i katedrës së Kimisë Organike, dekani i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, zv. Kryetari i Akademisë së Shkencave, Prof. Kolë Popa. Ai është një nga figurat më të shquara të arsimit e të shkencës shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX.

Kolë Popa lindi në qytetin e Elbasanit më 5 gusht 1913 në një familje intelektuale. I ati, Dr. Simon Popa ka qenë kryemjek i Elbasanit. Një vëlla i tij, Vasili, ka kryer studimet për mjekësi dhe ka jetuar e punuar në SHBA. Vëllai tjetër, që vdiq para kohe, ka qenë student i shkëlqyer, i diplomuar në Vjenë për filozofi dhe ekonomi; tri motrat e tij kanë qenë nxënese të dalluara në shkollë të mesme. Në këto rrethana ai ka pasur kushte për të marrë një edukatë të shëndoshë familiare që e ka ndihmuar gjatë gjithë jetës për të patur rezultate të mira si nxënës, student dhe në të gjithë jetën e tij aktive.



Shkollën fillore dhe të mesme i kreu me rezultate shumë të mira në qytetin e lindjes. Normalja e Elbasanit dallohej në atë kohë si një nga shkollat e mesme më të mira, ku jepeshin njohuri të plota në të gjitha lëndët dhe përgatiteshin mësues të zotë e me formim të gjithanshëm.

Studimet e larta Kolë Popa i kreu në Universitetin e Parias, Itali, në vitet 1930-1935, me rezultate shumë të mira, duke u diplomuar si kimist në degën e Kimisë Industriale dhe si farmacist në degën e Farmacisë. Në të njëjtën kohë, ai kreu edhe konservatorin e atij qyteti dhe u diplomua si instrumentist në violinë. Duke vlerësuar rezultatet e studimeve dhe cilësitë e Kolë Popës, profesorët e tij i propozuan për ta mbajtur si asistent. Dashuria për vendin dhe për familjen ndikuan që ai të mos i pranojë këto oferta dhe të kthehet në atdhe. Me kthimin në Shqipëri, profesor Kola u emërua mësues në Normalen e Elbasanit, ku punoi gjatë viteve 1935-1940, duke dhënë mësim në disa lëndë si Kimi, Fizikë, Biologji etj. Ndonëse ishte një mësues i ri, puna e tij vlerësohej lart, si nga kolegët, ashtu edhe nga nxënësit.

Gjatë luftës, në situatat e turbullta dhe të ndërlikuara politike të vendit, në sajë të ndjenjave patriotike dhe të ideve përparimtare, ai diti të orientohet shpejt, të marrë pjesë dhe të aktivizohet në Lëvizjen Nacional Çlirimtare, duke u zgjedhur anëtar i Këshillit Nacional Çlirimtar të qytetit të Elbasanit dhe më vonë, më 1944, anëtar i Këshillit të Frontit të Qarkut.

Me çlirimin e vendit, për afër 2 vjet punoi si përgjegjës i seksionit të shëndetësisë të Këshillit Popullor të Qarkut të Elbasanit. Pastaj u transferua në Tiranë si specialist në Ministrinë e Arsimit, në Komisionin Pedagogjik.

Në vitin 1950 Kolë Popa kalon në Institutin e Shkencave që ishte themeluar më 1946 dhe emërohet përgjegjës i seksionit të Shkencave Natyrore, ku punon deri në vitin 1957, kur ky institut i kaloi Universitetit Shtetëror të Tiranës si pjesë përbërëse. Gjatë punës në Institutin e Shkencave ai ka dhënë një kontribut të çmuar në caktimin e drejtimeve dhe organizimin e punës kërkimore shkencore në vend, në përcaktimin e tematikave, metodikave dhe formave të organizimit të punës etj. Në vitin 1953 ai ngriti Laboratorin e Kërkimeve Kimike, që është instituti i parë kërkimor shkencor në fushën e kimisë në vendin tonë, dhe ngarkohet me përgjegjësinë e drejtimit të tij. Njëkohësisht, gjatë kësaj periudhe, Prof. Kola ka dhënë lëndët e kimisë në shkollat e larta në Institutin Pedagogjik dhe në Institutin Bujqësor.

Themelimi i Universitetit të Tiranës ishte një ngjarje e shënuar dhe një hap shumë i madh përpara për riorganizimin, reformimin dhe zhvillimin e arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor në vendin tonë. Me kulturën e tij të gjerë dhe aftësitë organizative, Prof. Kolë Popa mori pjesë aktive dhe dha një kontribut

të çmuar për ngritjen dhe organizimin e universitetit. Ai u emërua që në fillim përgjegjës i Katedrës së Kimisë Organike në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe një vit më vonë edhe dekan i këtij Fakulteti, detyrë të cilën e mbajti për 16 vjet, deri më 1974, kur u transferua si zëvendës-kryetar i Akademisë së Shkencave.

Me formimin e lartë shkencor, me përvojën e gjithanëshme të fituar në studime dhe në punë, si edhe me intuitën e thellë për parashikime largpamëse, Prof. Kolë Popa dha një ndihmesë të veçantë në zgjidhjen e shumë problemeve që qëndronin para institucioneve të sapoformuara.

Një nga problemet e rëndësishme të fillimit, për të cilin profesor Kola kishte preokupim të madh dhe bëri shumë përpjekje, ishte siguri i mjediseve të punës. Zgjedhja dhe vendosja e Fakultetit të Shkencave të Natyrës në vendin ku është sot, ishte varianti më i mirë dhe më i studiuar për mundësitë e asaj kohe. Me zgjerimin e godinës ekzistuese dhe me ndërtime të dy godinave të tjera pranë u bë e mundur të përballoheshin në mënyrë të kënaqshme të gjitha nevojat e rritjes së vullshme të Fakultetit deri në ditët e sotme.

Një problem tjetër i rëndësishëm i kësaj periudhe ishte hartimi i planeve dhe i programeve mësimore. Duke konsultuar përvojën e shkollave perëndimore dhe të vendeve të lindjes dhe duke pasur parasysh kushtet e vendit tonë, u hartuan në mënyrë krijuese dhe origjinale planet dhe programet mësimore për përgatitjen e specialistëve të lartë me profil të përgjithshëm, të përshtatshëm për të punuar në fusha të ndryshme të prodhimit dhe të arsimit. Katedrat e Fakultetit të Shkencave Natyrore u përgatitën për të mbuluar disiplinat përkatëse edhe në të gjitha fakultetet e tjera të Universitetit. Prof. Kola udhëhoqi punën për zgjedhjen e teksteve më të mira nga literatura botërore dhe për përkthimin e përshtatjen e tyre për kushtet e shkollës sonë. Ai vetë dha shembullin i pari duke përshtatur për studentët tekstin e Kimisë Organike prej 1600 faqesh, me të cilin u përgatitën shumë gjenerata kimistësh në Tiranë e në Prishtinë.

Duke pasur parasysh natyrën e disiplinave shkencore kimike me karakter të theksuar praktik dhe eksperimental, një vëmendje të veçantë dhe një kohë shumë të madhe Prof. Kola i kushtoi ngritjes së bazës materiale laboratorike. Krahas udhëzimeve të hollësishme ai është marrë vetë me projektimin dhe ngritjen e laboratorëve si dhe me bërjen e porosive për pajisjen e tyre me aparaturat e nevojshme. Në këtë mënyrë, që brenda pak viteve u arrit të organizohen në mënyrë normale dhe në nivel të kënaqshëm për kohën, punët laboratorike në të gjitha disiplinat kimike. Duke ndjekur me kujdes zhvillimet bashkëkohore, Prof. Kola u bë pararendësi i futjes në Fakultet të metodave të reja të analizës, siç janë kromatografia në forma të ndryshme, spektroskopia

UV e IR, mas-spektroskopia, mikroskopia elektronike etj. dhe luftoi për gjetjen e rrugëve për kualifikimet e nevojshme të kuadrit dhe për sigurimin e aparaturës përkatëse.

Një meritë të veçantë në fushën e veprimtarisë shkencore, përveç angazhimit personal, Prof. Kola pati në përcaktimin e orientimit kryesor të drejtë të punës shkencore në fushën e kimisë dhe të shkencave të tjera të natyrës, që në mënyrë të përmbledhur ishte *“Njohja, studimi dhe vlerësimi i burimeve natyrore me prejardhje minerale dhe organike të vendit dhe zgjedhja e caktimi i rrugëve më të përshtatshme të shfrytëzimit të tyre”*. Ky orientim kryesor bëri të mundur që nga ana e punonjësve mësimorë-shkencorë të katedrave të kimisë, në veçanti, dhe të katedrave të tjera të Fakultetit, në përgjithësi, të ndërmerrej një numër i madh temash si: studimi i fosforiteve, i argjilave, i naftave, i bimëve foragjere, eterovajore, celulozike, mjekësore, i florës dhe i faunës së vendit etj. Për kryerjen e këtyre studimeve u aktivizuan me dhjetëra punonjës mësimorë dhe shkencorë dhe me qindra studentë. Rezultatet e këtyre studimeve janë konkretizuar në formën e dhjetëra monografive e të një numuri të madh artikujsh shkencorë, të dhjetëra disertacioneve e qindra punimeve të diplomave. Përveç kësaj, rezultatet e punës kërkimore shkencore në Universitet u kanë dhënë një ndihmë të dukshme edhe sektorëve të prodhimit e të kulturës. Nga ana tjetër, aktivizimi në punë shkencore i punonjësve mësimorë ka rritur kualifikimin shkencor të tyre dhe ka ngritur nivelin shkencor të procesit mësimor. Prof. Kola vazhdimisht theksonte se: *“Katedrat e Universitetit duhet të qëndrojnë në pararojë të mendimit shkencor të vendit”* duke e harmonizuar atë me procesin mësimor.

Nën drejtimin e Prof. Kolës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës u zbatuan mjaft forma të përparura për kohën, si: kërkesa që disa prej asistentëve të rinj të kryenin një fakultet të dytë, si p.sh. fizikanët që do të caktoheshin për punuar në katedrat e kimisë; dhënia e provimeve të thelluara për lëndët kryesore të katedrës ku emëroheshin etj. Edhe ato mundësi të pakta që ekzistonin për dërgime jashtë shtetit u shfrytëzuan kryesisht për studime të plota pasuniversitare, ose edhe për qëndrime afatshkurtëra, por me programe pune të qarta e të kontrollueshme. Përveç këtyre, edhe në udhëheqjen e kualifikimit të kuadrit të ri, Prof. Kola gjatë gjithë kohës ka dhënë shembull personal të admirueshëm, duke udhëhequr me sukses me dhjetëra disertantë për gradën e kandidatit e të doktorit të shkencave.

Në procesin e rritjes dhe të zhvillimit të veprimtarive shkencore u krijuan forma organizative të përshtatshme, si grupe pune, bërthama e qendra shkencore pranë katedrave, disa prej te cilave me zhvillimin e mëtejshëm ndikuan në krijimin e insituteve e të njëjësive të veçanta shkencore, si Insituti i

Kërkimeve Biologjike, Kopshti Botanik, Muzeu i Shkencave të Natyrës, Qendra e Matematikës Llogaritëse, Insituti i Fizikës Bërthamore etj.

Në vitin 1961 Fakulteti priti më shumë se 200 studentë që u kthyen nga shkollat e larta të vendeve të Lindjes, si pasojë e prishjes së marrëdhënieve politike me këto vende. Nën drejtimin e Prof. Kolës, për secilin nga këta studentë u hartua një program individual me synimin që, sa të ishte e mundur, tu ruhej profili i degës që kishin nisur në shkollat nga vinin. Mund të pohohet se brenda pak vitesh kjo detyrë u realizua me sukses.

Me zhvillimin dhe konsolidimin e katedrave, me forcimin relativ të bazës materiale laboratorike, me fitimin e përvojës dhe ngritjen e kualifikimit shkencor të kuadrit, nën udhëheqjen e Prof. Kolës pranë Fakultetit të Shkencave të Natyrës u krijuan edhe degë të reja; në vitin 1960 u krijua dega e Farmacisë, e cila në vitin 1970 kaloi në Fakultetin e Mjekësisë, kurse në vitin 1963 u krijua dega e Merceologjisë, e cila në vitin 1989 kaloi në Fakultetin e Ekonomisë. Gjithashtu, pranë degës së Kimisë Industriale në vitin 1970 u krijua specialiteti i përgatitjes së kimistëve teknologë për industrinë e naftës që funksionoi deri më 1977. Njëkohësisht pranë katedrave të Fakultetit të Shkencave të Natyrës u organizuan me dhjetëra kurse specializimi disa-mujore e vjetore të mikrobiologjisë, të teknologjive të ndryshme etj.

Faqe e ndritur e biografisë së Prof. Kolës është periudha 1970 – 1981, kur ai së bashku me bashkëpunëtorët e tij K. Koci, P. Troja e M. Haxhimusaj, ka dhënë kursin e plotë të Kimisë Organike në Universitetin e sapokrijuar të Prishtinës dhe ka ndihmuar në ngritjen e Departamentit të Kimisë pranë FSHN-sw së atij Universiteti, si dhe në kualifikimin e kuadrit shqiptar, që me kohë e çoi atë përpara. Këto kohë ai i kujtonte me shumë mall, ndërsa kolegët e tij të atjeshëm të kimisë e kujtojnë me shumë respekt e me mirënjohje të veçantë.

Për të gjitha meritat e përmendura në këtë shkrim, Prof. Kolë Popa u caktua anëtar dhe zëvendës-kryetar, që me krijimin e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë më 1972, detyrë të cilën ai mbajti për afër 20 vjet. Gjithashtu, që me krijimin e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Prof. Kola u zgjodh anëtar nderi i kësaj Akademie.

Në Akademinë e Shkencave Prof. Kola punoi në mënyrë intensive si zëvendës-kryetar dhe si përgjegjës i Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike, duke dhënë një kontribut të çmuar për të zhvilluar më tej veprimtarinë shkencore në vendin tonë. Prof. Kolë Popa ishte ideatori i krijimit të Qendrës së Kërkimeve Biologjike pranë Akademisë. Biblioteka

shkencore e Akademisë, e cila sot është një nga bibliotekat më të pasura të vendit, është vepër e konceptuar dhe realizuar nën drejtimin e Prof. Kolës. Në bashkëpunim të ngushtë me personalitetin dhe shkencëtarin e shquar, Prof. Aleks Buda, kryetarin e Akademisë së Shkencave, si dhe me kolegë të tjerë, ata konceptuan, ideuan, projektuan dhe realizuan shumë aktivitete të rëndësishme shkencore me karakter kombëtar, si dhe botimin e një vargu veprash të rëndësishme të karakterit të përgjithshëm e në fusha të veçanta si: Fjalori Enciklopedik Shqiptar botimi i parë i të cilit u realizua më 1985; u planifikua dhe u fillua puna për hartimin e veprës disa vëllimeshe Enciklopedia Shqiptare e të tjera. Në këtë kohë, Prof. Kolë Popa mori përsipër të hartojë Traktatin në 6 vëllime me titull: Nomenklatura Kimike në gjuhën shqipe. Ai arriti të botojë vëllimin I, si dhe të përfundojë së hartuari e të botojë në mënyrë të pjesme vëllimin II. Ndër aktivitetet shkencore, një vlerë të rëndësishme kanë pasur edhe konferencat shkencore me karakter kombëtar, si roli i kimisë në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit, të realizuar në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe me Universitetin e Prishtinës më 1991 etj.

Me gjithë angazhimet e mëdha në punë administrative dhe drejtuese si dhe në veprimtarinë mësimore e shkencore, Prof. Kolë Popa ka dhe një prodhimtari të pasur botuese. Ai është autor dhe bashkëautor i dhjetëra librave e monografive, si dhe i një numri të madh artikujsh e referimesh shkencore dhe studimesh të botuara në organe të ndryshme të vendit e të huaja. Ai dekoruar me urdhëra e medalje pune si dhe me Çmimin e Republikës.

Profesor Kolë Popa vdiq në Tiranë, në moshën 80-vjeçare, më 3 mars të vitit 1993, duke mbetur një emër i ndritur në historinë e arsimit të lartë dhe të shkencës shqiptare.